



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

Nr. _____ Prot.

Date ____/____/2021

Shtojca 10

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

21/12/2021

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “FASTECH” SH.P.K dhe adrese Njesia Bashkiake Nr. 5, rruga Brigada VIII, ndertesa 8, hyrja 6, ap 1, Tirane.

Procedura e prokurimit/lotit: **E hapur e thjeshtuar/ Mallra**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-14179-12-06-2021**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Blerje paisje kompjuterike per nevoja te administrates dhe mzsh-se”.**

Kohëzgjatja e kontratës: **5 dite nga data e nënshkrimit te kontrates.**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “FASTECH” SH.P.K, me Nuis J81609010U, me oferte ekonomike 1,715,600 (nje million e shtateqind e pesembedhjete mije e gjashteqind) lek pa TVSH,
2. Operatori Ekonomik “ATOM” SH.P.K, me Nuis L22203042N, me oferte ekonomike 1,726,000 (nje million e shtateqind e njezete gjashte mije) lek pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- 1- Operatori Ekonomik “ATOM” SH.P.K, me Nuis L22203042N,

Per arsyet e mëposhtme:

- I- Operatori Ekonomik “ATOM” SH.P.K, me Nuis L22203042N.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se:

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.5 te kriterëve te vecanta te kualifikimit ku parashikohet se: Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/ Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar per mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje autorizim distributori zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër qe provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per plotesimin e ketij kriteri operatorët ekonomike duhet te paraqesin autorizimin/ aktin e marrëveshjes me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Ne rast se paraqesin autorizim/marrëveshje distributori zyrtar duhet e bashkengjisin edhe autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër qe provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne SPE, konstatohet se per produktet Desktop 1 dhe Workstation Advanced, operatori ekonomik ka autorizim distributori nga **“Komtrejd Distribucija DOOEL Skopje”**, por nuk ka paraqitur dokument qe provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar, pasi marrëveshje me prodhuesin qe OE ka paraqitur eshte lidhur midis Hewlett-Packard (HP) dhe **“CT Computer MK DOOEL Skopje”**, duke mos provuar lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Gjithashtu operatori ekonomik ka paraqitur nje deklarate nga **“Komtrejd Distribucija DOOEL Skopje”**, i cili deklaron se ka ndryshuar emrin ne **“CT Computer MK DOOEL Skopje”**, por KVO thekson se per te vertetuar ndryshimin e emrit te nje subjekti tregtar nevojitet nje vertetim nga autoritetet shteterore pergjegjese dhe jo nje deklarate nga subjekti.

Sa me siper KVO veren se distributori i cili ka marrëveshje me operatorin ekonomik nuk eshte i njejte me distributorin i cili ka marrëveshje me prodhuesin, dhe ky kriter konsiderohet i pa permbushur.

Se dyti, nuk ploteson kriterin 2.3.6 te DST-se ku parashikohet se: Operatori ekonomik duhet te paraqese katalog me te dhenat teknike per artikujt qe oferton. Ne katalog te markohet ne menyre te qarte dhe te dallueshme secili nga artikujt qe oferton sipas modelit te deklaruar dhe te shenohen per te gjith artikujt objekt prokurimi. Katalogu te permbaje karakteristikat teknike te cdo artikulli qe eshte objekt i prokurimit me qellim qe autoriteti kontraktor te vleresoje nese malli i ofruar ploteson kerkesat teknike te percaktuara ne dokumentat e tenderit.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per plotesimin e ketij kriteri operatorët ekonomike duhet te paraqesin katalog me te dhenat teknike per artikujt qe oferton si dhe katalogu duhet te permbaje karakteristikat teknike te cdo artikulli qe eshte objekt i prokurimit me qellim qe autoriteti kontraktor te vleresoje nese malli i ofruar ploteson kerkesat teknike te percaktuara ne dokumentat e tenderit.

Nga verifikimi e dokumentacionit te paraqitur ne SPE konstatohet se operatori ekonomik ka paraqitur katalog ne gjuhen angleze, i cili rezulton te jete i pa perkthyer ne gjuhen shqipe.

KVO veren se ne piken 2, te nenit 24, te VKM-se 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se: *2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.*

Gjtithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin nr. 825/2021, mban te njejtin qendrim ne te cilin theksohet se: ***“II.4.4. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar përcaktimeve ligjore mbi përdorimi e gjuhës shqipe në dokumentet e tenderit, për të qenë sa më të kuptueshme për palët dhe për të krahasuar përputhshmërinë e parametrave dhe të dhënave të mallit që prokurohet, është e nevojshme që për artikujt, objekt-prokurimi, të dhënat e katalogut të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe, gjuhë e përdorur në dokumentet e procedurës së prokurimit. Në këtë kuptim KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar kriterin në përputhje me dispozitat ligjore dhe kriteri nuk le vend për konfuzion”.***

Bazuar ne sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave nenvizon se katalogjet duhet te jene te perkthyer ne gjuhen shqipe me qellim krahasimi nga KVO me specifikimet teknike te paraqitura ne DST.

Si perfundim, dokumentacioni i paraqitur nga OE per plotesimin kriteri 2.3.6 nuk eshte ne perputhje me piken 2 te nenit 24, te VKM-se 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke mos permbushur kete kriter.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për

përbushjen e këtyre kritereve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “ATOM” SH.P.K, për mos përmbushje të kritereve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “ATOM” SH.P.K, me Nuis L22203042N, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “FASTECH” SH.P.K, me adresë Njësia Bashkiake Nr. 5, rruga Brigada VIII, ndertesa 8, hyrja 6, ap 1, Tirane, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 1,715,600 (një milion e shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) lek pa TVSH është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI AUTORITETIT KONTRAKTOR
K R Y E T A R I
Pjerin NDREU**